

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SRL GROUP” Sh.p.k

Sot, me date 01/02/2025 ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, themeluesit:

- 1. ROLAND TOPALLI , madhor dhe me zotesi te plote juridike, banues ne Lezhe, lindur me 01/11/1996 I identifikuar me nr personal sipas ID J61101046J , sot me daten 01/02/2025 harton dhe miraton Statutin e Shoqerise Tregtare "SRL GROUP" sh.p.k.**
- 2. EDI GEGA , madhor dhe me zotesi te plote juridike, banues ne Lezhe, lindur me 18/11/1976 I identifikuar me nr personal sipas ID H61118056H , sot me daten 01/02/2025 harton dhe miraton Statutin e Shoqerise Tregtare "SRL GROUP" sh.p.k.**

**ne cilesine e ortaeve themelues kane vendosur te krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ,
e emertuar “SRL GROUP” Sh.p.k**

KREU I

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- 1.1 Krijohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e cila ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe aktet tjera ligjore qe jane ne fuqi.**
- 1.2 .Akti i themelimit eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te, rregullohen nga statuti, nga ligji “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe legjislacioni shqiptar si dhe ne kontrata respektive.**

NENI 2

EMERTIMI I SHOQERISE

- 2.1.Shoqeria mban emrin “SRL GROUP” Sh.p.k dhe eshte person juridik shqiptar.**



2.2. Shoqeria "SRL GROUP" Sh.p.k (ne vijim "Shoqeria") krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me 2 (dy) ortakte te cilet jane:

1. ROLAND TOPALLI , madhor dhe me zotesi te plote juridike, banues ne Lezhe, lindur me 01/11/1996 I identifikuar me nr personal sipas ID J61101046J , sot me daten 01/02/2025 harton dhe miraton Statutin e Shoqerise Tregtare "SRL GROUP" sh.p.k.
2. EDI GEGA , madhor dhe me zotesi te plote juridike, banues ne Lezhe, lindur me 18/11/1976 I identifikuar me nr personal sipas ID H61118056H , sot me daten 01/02/2025 harton dhe miraton Statutin e Shoqerise Tregtare "SRL GROUP" sh.p.k.

dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij akti themelimi.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

3.1. Shoqeria e ka qendren ne : Zyrë në lagjen "Besëlidhja", Bulevardi "Gjergj Fishta", ndërtesë private 5-katëshe, në zonën kadastrale nr.8632, numri i pasurisë 7/149-N4, kati 3-të, Lezhë dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj

3.2.Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

4.1.Shoqeria "SRL GROUP" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.R.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

5.1. Shoqeria eshte themeluar per te vepruar me kete objekt veprimtarie:

5.1.1 . ► Import-Eksport dhe tregim me shumice e pakice te fruta perimeve dhe produkte te tjera ushqimore. ► Perpunim dhe tregtim i ullinjeve dhe nenprodukteve te tij. ► Sherbime logjistike.

5.2.Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise

NENI 6

PERGJEGJESIA E ORTAKEVE

6.1.Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakteve.

6.2.Ortaket qe marrin pjese ne kete shoqeri, nuk jane pergjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj, qe vete ata kane nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te ortakteve te saj.



KREU II

NENI 7

KAPITALI I SHOQERISE

7.1. Kapitali fillestar i shoqerise "SRL GROUP" sh.p.k perbehet nga para me nje vlere te barabarte me 1.000.000 (Nje milion) leke.

Kapitali themeltar eshte i ndare sipas kontributeve si me poshte:

1. ROLAND TOPALLI vlere nominale 500.000 leke / perqindje 50 %
2. EDI GEGA vlere nominale 500.000 leke / perqindje 50 %

NENI 8

8.1. Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar do te shenohet kapitali derdhur nga ortaket e shoqerise. Rritja dhe zvogelimi i kapitalit fillestar te shoqerise percaktohet sipas rregullave te percaktuara ne statutin e shoqerise me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 9

SHLYERJA E KAPITALIT THEMELTAR

9.1. Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaket e shoqerise.

KREU III

NENI 10

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

10.1. Asambleja e Pergjithshme.

Administratori ose administratoret e shoqerise.

10.2. Modalitetet dhe procedurat e emerimit, shkarkimit, kohezgjatja e mandatit dhe kompetencat e administratorit caktohen ne statutin e shoqerise.

10.3. Administratori i shoqerise emerohet jete z. Roland Topalli madhor dhe me zotesi te plote juridike, lindur ne Nenshat dhe banues ne Lezhe, me 01/11/1996 I identifikuar me nr personal sipas ID J61101046J i cili do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 2 vjeçar.

NENI 11

TE PERGJITHSHME

11.1. Shoqeria do te kete simbolet dhe vulen e saj personale, ku jane shenuar inicialet e saj te emertimit te saj. Fillimin e aktivitetit te saj tregtar kjo shoqeri e lidh me regjistrimin prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe me marrjen e NIPT-it perkates.



NENI 12

12.1.Dispozita me te hollesishme jane parashikuar ne Statutin e kesaj shoqerie, i cili shpreh vullnetin e lire te themeluesve.

NENI 13

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

13.1.Ky Akt-Themelimi u redaktua ne 6 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte juridike.

ORTAKET THEMELUES

ROLAND TOPALLI



EDI GEGA

